



REPUBLIKA E SHQIPËRIË
MINISTRIA E KULTURËS
KËSHILLI KOMBËTAR I RESTAURIMEVE

VENDIM

Nr. 139, dt. 15.06.2016

Në mbështetje të ligjit nr. 9048, datë 07.04.2003, “Për Trashëgiminë Kulturore”, i ndryshuar, Këshilli Kombëtar i Restaurimeve, në mbledhjen e datës 15.06.2016, pasi shqyrtoi termat e referencës të diskutuara më parë dhe në Këshillin Shkencor të Institutit të Monumenteve të Kulturës,

VENDOSI:

1. Miratohen termat e referencës për:
 - Detyrë Projektimi: Përgatitje e Master Planit të Parkut Kombëtar Butrint (Pasuri Botërore), hartimi i projekteve konservuese dhe restauruese të detajuara brenda zonës së qytetit antik si dhe përgatitje e dosjes së tenderit për zbatimin e punimeve konservuese dhe restauruese.
 - Detyrë Projektimi: Për hartimin e projekteve konservuese dhe restauruese në “Parkun Arkeologjik Kombëtar Amantia, Vlorë”.
 2. Ngarkohet Qendra Kombëtare e Inventarizimit të Pasurisë Kulturore për regjistrimin e këtij vendimi.
 3. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
MIRELA KUMBARO FURXHI



SEKRETAR I KKR

ARTA DOLLANI